



**INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I TRAJNIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË  
DETYRUAR TË GJIMNAZIT**

**FUSHA: SHKENCA SHOQËRORE**

**LËNDA: TRASHËGIMIA KULTURORE**

**KODI: 8.7.11.Z**

**PROGRAMI I LËNDËS TRASHËGIMIA KULTURORE  
EVROPIANE**

**PËR KLASËN E 11<sup>të</sup>**

**TIRANË, DHJETOR 2009**

Lënda me zgjedhje “Trashëgimia Evropiane” i kushtohet njohjes së vlerave të veçanta natyrore, por edhe humane të krijuara nën veprimin e ligjësive natyrore dhe nga popujt e kontinentit tonë. Zhvillimi i kësaj lënde ndihmon fuqimisht formimin dhe edukimin qytetar të brezit të ri, i cili duhet të njohë, të respektojë, dashurojë, mbrojë dhe të pasurojë vazhdimisht vlerat më të spikatura të kulturës dhe të natyrës së vendit të vet dhe të gjithë vendeve të tjera të Evropës.

Lënda, si fushë ndërdisiplinore, integron në një subjekt të vetëm konceptet e përfituara nga lëndë të tjera mësimore, si: historia, gjeografia, gjuha dhe letërsia, edukimi muzikor, teknologjia etj. Duke mos i përsëritur këto lëndë, ajo përqendrohet në konceptin e përcaktuar nga UNESCO për trashëgiminë natyrore dhe kulturore, duke vënë theksin në kriteret e vlerësimit dhe identifikimit të trashëgimisë natyrore e kulturore kombëtare dhe evropiane, në përcaktimin e rrugëve të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit për qëllime studimore, formuese qytetare e edukuese (ekologjike e atdhetare), turistike dhe për kënaqësi estetike.

Trajtimi i këtyre problemeve në kuadrin e kurrikulës së gjimnazit synon t'i kundërvihet tendencës së sotme të rrafshimit të vlerave kombëtare, të zhdukjes së këtyre vlerave, të humbjes së identitetit natyror, kulturor dhe shpirtëror kombëtar. Kjo tendencë është rezultat i zhvillimeve të sotme në botë, i globalizimit të ekonomisë, të jetës, kulturës dhe gjithçkaje tjetër. Me analizat shkencore të vlerave të veçanta natyrore dhe të kulturës evropiane dhe kombëtare, me trajtesat emocionuese të bukurisë dhe larmisë së jashtëzakonshme të monumenteve të natyrës dhe të kulturës, lënda e re ndihmon në formimin e të rinjve me këto vlera, duke ndihmuar kështu në forcimin e identitetit kombëtar dhe evropian vendosjen e raporteve të drejta midis identitetit kombëtar, evropian dhe si qytetar i gjithë botës. Klasa 10 ka pasur në fokusin e vet trashëgiminë kombëtare, klasa 11 krijon mundësi ballafaqimi me trashëgiminë evropiane duke zbuluar pasurinë që vjen nga diversiteti natyror dhe kulturor dhe ndikimet reciproke të trashëgimisë kombëtare dhe asaj evropiane tek njera tjetra. Njëherazi në këtë kontekst, lënda krijon mundësinë e njohjes së rrugëve të vlerësimit dhe të mbrojtjes prej rrezikut të dëmtimit e humbjes së identitetit natyror, kulturor dhe shpirtëror kombëtar dhe evropian. Vlerësimi pozitiv i fituar nga futja e kësaj lënde në shkollë do të pasqyrohet edhe në rritjen e qëndrimeve aktive të nxënësve ndaj trashëgimisë evropiane, si dhe mospajtimin e tyre me pseudo vlerat. Raporti teori – veprimtari praktike apo njohuri – aftësi rekomandohet të jetë 48 orë njohuri dhe 24 orë realizimi projektesh, megjithatë sugjerohet që zhvillimi i lëndës mësimore të realizohet edhe në varësi të rrethanave shkollore dhe vendore.

## **1. SYNIMI I LËNDËS**

Lënda ka për synim të zhvillojë tek nxënësit njohjen dhe aftësimin me:

- konceptet bazë të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- njohuri mbi Evropën: kushtet natyrore që mundësuan pasurinë e madhe të trashëgimisë natyrore të saj; popullimin e hershëm dhe veprimtarinë intensive jetësore dhe ekonomike të popullsisë në Evropë në tërësi dhe rajonit të Evropës juglindore dhe mesdhetare në veçanti, rolin e tyre në trashëgiminë shumë të pasur kulturore të këtij kontinenti
- sitet evropiane më interesante të Listës së trashëgimisë evropiane;
- vlerat dhe kategoritë e kësaj trashëgimie;

- rrugët e mbrojtjes të kësaj trashëgimie: mbështetjen ligjore dhe institucionale ndërkombëtare (Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit kulturor të Parisit, 20 tetor 2005) dhe kombëtare; me identifikimin e vlerave të kategorive të ndryshme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- mënyrat dhe rrugët e shfrytëzimit të tyre për qëllime studimore, formuese qytetare e edukuese dhe turistike të trashëgimisë natyrore e kulturore.

Krahas njohjes se aspekteve teorike, ajo synon që t'i aktivizojë nxënësit edhe në veprimtari praktike për evidentimin e vlerave të trashëgimisë dhe mbrojtjen e këtyre vlerave. Për këtë qëllim janë planifikuar disa orë veprimtari praktike, në të cilat vetë nxënësit do të vlerësojnë objekte të veçanta të natyrës dhe kulturës së vendeve të ndryshme evropiane dhe do të marrin pjesë në promovimin, mbrojtjen dhe përcaktimin e rrugëve të shfrytëzimit për qëllime të ndryshme edukuese dhe turistike të këtyre vlerave

## 2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi nxënës/i, - ja:

- Të përcaktojë kriteret e vlerësimit dhe të cilësimit të trashëgimisë **kulturore dhe natyrore**;
- Të kuptojë lidhjet ndërmjet dukurive fiziko-geografike dhe trashëgimisë natyrore; midis zhvillimeve sociale, historike, politike, kulturore dhe ekonomike të shoqërisë dhe trashëgimisë kulturore të saj;
- Të demonstrojë ndërgjegjësim për trashëgiminë e pasur natyrore dhe kulturore evropiane;
- Të vlerësojë dhe të respektojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të të gjitha vendeve të tjera të Evropës ;
- Të kuptojë domosdoshmërinë e njohjes së vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore për edukimin ekologjik dhe global, për zhvillimin e turizmit etj.
- Të listojë qendrat dhe monumentet më interesante natyrore dhe kulturore të Listës së Trashëgimisë së vendeve evropiane;
- Të zhvillojë aftësitë e hartimit dhe zbatimit të projekteve në fushën e trashëgimisë natyrore dhe kulturore duke njohur kontekstin evropian
- Të zhvillojë aftësitë e organizimit në OJF për njohjen e vlerave natyrore dhe kulturore, binjakëzimet e shkollave në kontekstin evropian
- Të organizojë veprimtari të ndryshme me qëllim promovimi në fushën e trashëgimisë evropiane
- Të evidentojë faktorët që kanë ndikuar në larminë e monumenteve kulturore evropiane
- Të vlerësojë monumentet e kulturës me vlera evropiane për të kaluar në veprime aktive për mbrojtjen e tyre

### 3. OBJEKTIVAT SIPAS LINJAVE TË LËNDËS

#### Linja 1: TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE

**Përshkrimi i linjës:** Trashëgimia natyrore dhe kulturore evropiane përbëhet nga vlera dhe site të veçanta, unikale në shkallë kontinenti. Site e saj dallohen nga biodiversiteti i theksuar dhe peizazhi i veçantë, ku gjenden objekte të rralla gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike etj. Jo rrallë në këto site të trashëgimisë natyrore takohen edhe vlera të veçanta kulturore.

Trashëgimia kulturore përfshin objektet më domethënëse të arkeologjisë, arkitekturës, shkencës ose teknologjisë së kulturave të veçanta.

Këto lloj trashëgimish shërbejnë si një komponent i rëndësishëm në industrinë e turizmit të një vendi, mjaft tërheqës për shumë vizitorë të jashtëm, sa edhe për ata vendas.

Në vitin 2009 Lista e Trashëgimisë Botërore numëron 890 qendra nga të cilat kulturore 689, natyrore 176 qendra dhe 25 site mikse. Secili prej këtyre siteve cilësohet shumë i rëndësishëm për komunitetin ndërkombëtar. Një pjesë e madhe e tyre i përkasin kulturës dhe natyrës evropiane

#### Orët e sugjeruara: 5

Linja	Objektiva
Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore	<p>Në përfundim të studimit të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Të përkufizojë lëndën e trashëgimisë natyrore dhe kulturore evropiane.</b></li><li>• <b>Të zotërojë njohuri mbi Evropën:</b> kushtet e veçanta natyrore që mundësuan pasurinë e madhe të trashëgimisë natyrore të saj; popullimin e hershëm, veprimtarinë intensive jetësore dhe ekonomike të popullsisë në Evropë në tërësi dhe rajonit të Evropës juglindore dhe mesdhetare në veçanti, rolin e tyre në trashëgiminë shumë të pasur kulturore të këtij kontinenti.</li><li>• <b>Të shpjegojë</b> trashëgiminë kulturore evropiane dhe identitetin evropian.</li><li>• <b>Të shpjegojë</b> domosdoshmërinë e lidhjes mes vlerave të trashëgimisë kulturore dhe kujdesit për ruajtjen e tyre deri në ditët tona.</li><li>• <b>Të përshkruajë</b> trashëgiminë natyrore dhe kulturore evropiane (të luajtshme dhe të paluajtshme) si dhe veçoritë e saj <b>si trashëgimi pakufi.</b></li><li>• <b>Të vizitojë</b> monumente të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në sitet e internetit ose duke bërë kërkime në materiale të printuara (albume, studime, revista etj).</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të ndërtojë</b> vetë apo në grup albume me materialet e nxjerra nga kërkimet e bëra për monumentet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në qendrat e internetit.</li> </ul>
--	--

## Linja 2: TRASHËGIMIA KULTURORE MATERIALE

**Përshkrimi i linjës:** Objektet janë të rëndësishme për studimin e historisë sepse ato japin një bazë konkrete për idetë dhe mund t'i bëjnë të vlefshme ato. Në këtë linjë nxënësit kuptojnë domosdoshmërinë e njohjes së të kaluarës evropiane nëpërmjet vendeve historike, mjediseve gjeografike, kalave, monumenteve, objekteve, etj. Njohja me veprat e artit dhe monumentet e natyrës është një pjesë e rëndësishme që brezat i përcjellin njeri tjetrit si pasuri e pakufi dhe me vlera të mëdha identiteti njerëzor evropian dhe më gjerë. Trashëgimia materiale është më e lehtë për t'u ruajtur dhe për t'u promovuar se sa trashëgimia shpirtërore pasi qendrat historike dhe muzetë, veprat historike dhe artistike janë të mirëpërcaktuara fizikisht dhe të mbrojtura me ligje dhe rregulla të veçanta.

**Orët e sugjeruara: 24**

Linja	Objektivat
<b>Trashëgimia Materiale</b>	<p>Në përfundim të studimit të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të përkufizojë përmbajtjen e termit trashëgimi kulturore evropiane materiale</b> (e luajtshme dhe e paluajtshme)</li> <li>• <b>Të identifikojë tipologjitë kryesore të trashëgimisë kulturore materiale evropiane</b></li> <li>• Të kategorizojë monumentet kulturore të antikitetit në hapësirën evropiane pjesë e “<i>World Heritage list</i>”, UNESCO si <ul style="list-style-type: none"> <li>a. <i>Rrënojat antike</i></li> <li>b. <i>Qytetet antike</i></li> <li>c. <i>Parqet arkeologjike</i></li> <li>d. <i>Trashëgiminë arkeologjike nënujore dhe rëndësinë e saj</i></li> </ul> </li> <li>• <b>Të analizojë</b> dhe të krahasojë monumentet kulturore të antikitetit në vende të ndryshme.</li> <li>• <b>Të shpjegojë historikun e monumenteve evropiane të kultit</b>, pjesë e “<i>World Heritage list</i>”, UNESCO, si <ul style="list-style-type: none"> <li>a. <i>Kishat</i></li> <li>b. <i>Katedralet</i></li> <li>c. <i>Manastiret dhe vendet e shenjta</i></li> </ul> </li> <li>• <b>Të identifikojë qendrat historike</b> të qyteteve evropiane, pjesë e “<i>World Heritage list</i>”, UNESCO, dhe të shpjegojë rëndësinë e qendrave historike të qyteteve evropiane</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të përshkruajë</b> vlerat arkitekturore të <i>disa qyteteve të vjetra dhe qendrave historike të Evropës</i></li> <li>• <b>Të dallojë</b> përmes interpretimit të fotove apo filmimeve disa qytete dhe qendra historike evropiane;</li> <li>• <b>Të dallojë dhe të përshkruajë</b> fortifikimet, pjesë e “<i>World Heritage List</i>”, UNESCO, si       <ul style="list-style-type: none"> <li>a. <i>Kalatë</i></li> <li>b. <i>Kështjellat</i></li> </ul> </li> <li>• <b>Të identifikojë</b> monumentet kryesore të trashëgimisë kulturore evropiane në sitet e internetit, në adresën e UNESCO-s</li> <li>• <b>Të identifikojë</b> trashëgiminë kulturore materiale evropiane të luajtshme,</li> <li>• <b>Të krahasojë</b> vlerat dhe rëndësinë e saj për .       <ul style="list-style-type: none"> <li>a. <i>Veprat e artit</i></li> <li>b. <i>Objektet etnografike</i></li> <li>c. <i>Kostumet dhe veglat muzikore</i></li> </ul> </li> <li>• <b>Të listojë</b> 10 veprat më të njohura të artit evropian (piktura, skulptura, etj)</li> <li>• <b>Të demonstrojë</b> se njeh fazat e restaurimit që ndiqen për veprat e artit, njohuri të cilat fitohen përmes dokumentarëve të kësaj natyre</li> <li>• <b>Të dallojë</b> kostumet popullore të vendeve të ndryshme evropiane</li> <li>• <b>Të vlerësojë</b> kombinimet e ngjyrave në kostumet popullore, sipas llojit të ceremonisë , moshës, zonës (detare, malore)</li> <li>• <b>Të ndërtojë</b> stenda me materialet e grumbulluara për t’i përdorur në evenimente të ndryshme, si p.sh për festat kombëtare të këtyre vendeve,</li> <li>• <b>Të dallojë</b> mjeshtër evropianë të fotografisë artistike</li> <li>• <b>Të emërtojë historinë</b> ose praktikën e ekspozimeve të fotografisë artistike dhe bienaleve që përdorin pikërisht këtë lloj arti</li> <li>• <b>Të listojë disa nga</b> institucionet më të rëndësishme evropiane te ruajtjes se trashëgimisë kulturore materiale, si :       <ul style="list-style-type: none"> <li>a. <i>Muzetë dhe arkivat</i></li> <li>b. <i>Institucionet e restaurimit dhe mbrojtjes së monumenteve</i></li> <li>c. <i>Institucionet e gërmimit arkeologjik</i></li> <li>d. <i>Institucionet e katalogimit dhe digjitalizimit të trashëgimisë kulturore</i></li> </ul> </li> <li>• <b>Të identifikojë dhe të përdorë</b> emërtime dhe adresa interneti për njohjen e galerive të famshme të artit me materiale për Rilindjen evropiane apo periudhat e tjera si p.sh Firencen, Luvrin, etj.</li> </ul>
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të përgatisë</b> guida/udhëtime imagjinare në qendra të rëndësishme të trashëgimisë kulturore evropiane</li> <li>• <b>Të paraqesë</b> objekte të kulturës materiale në miniekspozita, sipas krahinës së vendit tonë dhe atje ku është e mundur edhe të një vendi tjetër evropian që nxënësi/ja parapëlqen.</li> </ul>
--	---

### Linja 3: TRASHËGIMIA KULTURORE SHPIRTERORE

**Përshkrimi i linjës:** Në këtë linjë nxënësit kuptojnë elementet e identitetit human, evropian dhe global që lidhen me zhvillimin shoqëror të vendeve të ndryshme. Trashëgimia shpirtërore konsiston në aftësitë tradicionale, besimet, traditat, muzikën, këngët, vallëzimin, dramën, etj. Të gjitha këto nuk mund të qëndrojnë në muze, por interpretohen dhe përcillen nga një brez në tjetrin dhe nga një rajon në tjetrin. Karakteristikat e vlerave historike, artistike dhe shkencore të kësaj trashëgimie trupëzohen në monumentet dhe kryeveprat e realizuara nga popujt dhe personalitetet e shquara të trashëgimisë kulturore në fushat e gjuhësisë, folklorit, artit pamor dhe muzikor, lojërave dhe valleve, ritualeve dhe festave, etj. Linja u ofron nxënësve njohje dhe aftësim praktik me listën e shpallur të monumenteve shpirtërore evropiane ku përfshihen edhe ditët ndërkombëtare të trashëgimisë shpirtërore. Veprimtaritë praktike si organizimi i panairëve dhe ekspozitave, projektet e binjakëzimit të shkollave zënë vend të rëndësishëm në edukimin e të rinjve me trashëgiminë kulturore shpirtërore evropiane

**Orët e sugjeruara: 20**

Linja	Objektivat
Trashëgimia Shpirtërore	<p>Në përfundim të studimit të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të identifikojë përmbajtjen dhe strukturën e trashëgimisë shpirtërore evropiane</b></li> <li>• <b>Të shpjegojë</b> rëndësinë dhe veçoritë e kryeveprave të trashëgimisë shpirtërore</li> <li>• <b>Të klasifikojë kryeveprat e trashëgimisë shpirtërore</b> të njerëzimit në Evropë</li> <li>• <b>Të dallojë</b> simbolet shpirtërore të Evropës si : <ul style="list-style-type: none"> <li>a. <i>Flamurin zyrtar të Evropës</i></li> <li>b. <i>Himnin zyrtar të Evropës së bashkuar</i></li> <li>c. <i>Flamujt dhe himnet kombëtare.</i></li> </ul> </li> <li>• <b>Të përshkruajë</b> folklorin vokal, folklorin muzikor instrumental dhe veglat muzikore popullore më të përhapura evropiane</li> <li>• <b>Të dëgjojë këngë të folklorit muzikor</b> nëpërmjet regjistrimeve në CD, veglave muzikore tradicionale,</li> <li>• Të identifikojë veçantitë dhe të përbashkëtat në folklorin muzikor dhe vallëzimet popullore të</li> </ul>

	<p>vendeve evropiane.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të këndojë disa</b> këngë të folklorit muzikor evropian</li> <li>• <b>Të identifikojë</b> disa nga llojet e vallëzimit popullor evropian</li> <li>• <b>Të tregojë</b> karakteristikat e disa vallëzimeve popullore në Evropë.</li> <li>• <b>Të listojë</b> 10 kryevepra muzikore popullore evropiane</li> <li>• <b>Të përshkruajë</b> lidhjen ndërmjet folklorit muzikor, vallëzimit popullor dhe zakoneve tradicionale të popujve evropiane.</li> <li>• <b>Të identifikojë disa zakone tradicionale evropiane.</b></li> <li>• Të emërtojë disa nga lojërat popullore evropiane</li> <li>• Të përshkruajë ngjarje festive dhe rituale të ndryshme evropiane</li> <li>• <b>Të përshkruajë</b> origjinën e tyre dhe lidhjen me psikologjinë kombëtare.</li> <li>• Të shpjegojë lidhjen e folklorit muzikor, vallëzimit muzikor dhe zakoneve tradicionale me mjedisin dhe kohën e krijimit.</li> <li>• <b>Të dallojë disa</b> kryevepra nga fusha rituale popullore evropiane</li> <li>• <b>Të diskutojë</b> për disa nga llojet e tyre.</li> <li>• <b>Të dallojë disa</b> kryevepra të spektaklit popullor dhe të shpjegojë rrethanat historike dhe shoqërore të lindjes së tyre</li> <li>• <b>Të analizojë veçoritë e zhvillimit të teatrit</b> tradicional evropian në periudha të ndryshme historike</li> <li>• Të ideojë një projekt për njohjen më të thellë të një elementi të caktuar të kulturës shpirtërore evropiane</li> <li>• Të shohë video të festivaleve apo të ndjekë aktivitete kulturore që zhvillohen në Evropë.</li> <li>• <b>Të përshkruajë rolin dhe funksionet kryesore</b> të institucioneve evropiane që merren me trashëgiminë kulturore shpirtërore.</li> <li>• <b>Të shpjegojë domethënien e ditëve evropiane, si:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. 9 Maji, “<i>Dita e Evropës</i>”</li> <li>b. 20 shtatori, Dita kulturore e Evropës</li> <li>c. 26 shtatori, Dita Evropiane e gjuhëve</li> <li>d. 24 maji, Dita Evropiane e Parqeve natyrore</li> </ol> </li> <li>• Të përshkruajë domethënien dhe rëndësinë e këtyre ditëve.</li> <li>• <b>Të zhvillojë një projekt</b> që ndihmon ndërgjegjësimin e të rinjve për përpjekjet në</li> </ul>
--	---



	<p>mbrojtje të trashëgimisë kulturore evropiane.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të organizojë aktivitete dhe të jetë pjesëmarrës</b> për ditët evropiane të kulturës në klasën e vet</li> </ul>
--	--

#### Linja 4: TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE

**Përshkrimi i linjës:** Në këtë linjë nxënësit kuptojnë vlerat e rralla, unikale të siteve të natyrës të Evropës. Ata njohin elementet që rrezikojnë vlerat e trashëgimisë natyrore dhe ndërgjegjësohen për t'i mbrojtur qendrat e saj nga zhdukja dhe dëmtimi. Njohja e veprimeve konkrete, aksioneve dhe projekteve të ndryshme evropiane i aftëson ata për të kapërcyer problemet e ndryshme që paraqet zhvillimi industrial dhe i formon me konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm. Njohja me institucionet dhe OJF evropiane që mbrojnë qendrat natyrore është një tjetër drejtim i rëndësishëm që do të zhvillojë tek ata aftësitë e të konceptuarit të projekteve dhe zbatimit të tyre.

**Orët e sugjeruara: 10**

Linja	Objektivat
<p><b>Trashëgimia kulturore dhe mjedisi</b></p>	<p>Në përfundim të studimit të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të aftësohet për të promovuar vlerat e trashëgimisë natyrore evropiane</b> dhe për të ndërmarrë aktivitete praktike në mbrojtje të vlerave të kësaj trashëgimie.</li> <li>• <b>Të dallojë</b> sistemet e diferencimit të trashëgimisë natyrore në Evropë: trashëgimia botërore dhe kombëtare;</li> <li>• <b>Të kuptojë vendin që zë trashëgimia e veçantë natyrore evropiane në trashëgiminë e përgjithshme botërore;</b></li> <li>• Të përcaktojë kriteret e evidentimit të objekteve natyrore si trashëgimi e veçantë natyrore;</li> <li>• Të përvetësojë ligjësitë e krijimit dhe evoluimit të trashëgimisë natyrore;</li> <li>• <b>Të rendisë trashëgiminë natyrore evropiane</b> në “Ëorl Heritage List”, UNESCO si dhe kriteret e anëtarësimit të objekteve dhe qendrave evropiane në këtë listë;</li> <li>• <b>Të identifikojë</b> parqet dhe monumentet natyrore evropiane</li> <li>• <b>Të shpjegojë</b> rëndësinë e tyre në pasuritë natyrore botërore</li> <li>• <b>Të dallojë</b> 10 qendra natyrore të përfshira në trashëgiminë natyrore evropiane</li> <li>• Të përvetësojë konceptin e trashëgimisë natyrore evropiane dhe konceptin e zonës së mbrojtur;</li> <li>• <b>Të dallojë</b> disa sisteme të klasifikimit të</li> </ul>

	<p>trashëgimisë kombëtare në vende të ndryshme të Evropës</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të dallojë kriteret e klasifikimit të zonave të mbrojtura sipas IUCN-së;</b></li> <li>• <b>Të klasifikojë</b> listën e qendrave të trashëgimisë natyrore evropiane të rrezikuara;</li> <li>• Të shpjegojë institucionet evropiane dhe rolin e OJF për ruajtjen e zonave të mbrojtura;</li> <li>• Të listojë organizatat më të njohura evropiane në fushën e mbrojtjes së mjedisit</li> <li>• <b>Të dallojë</b> rreziqet natyrore dhe antropogjenë që kërcënojnë vlerat e trashëgimisë natyrore evropiane;</li> <li>• <b>Të përshkruajë rëndësinë e mjedisit natyror evropian si element kulturëbërës.</b></li> <li>• Të vlerësojë mbrojtjen e mjedisit natyror evropian.</li> <li>• Të memorizojë dhe identifikojë më shumë se 10 objekte nga lista e monumenteve të natyrës në Evropë</li> <li>• <b>Të përshkruajë veçoritë e tyre.</b></li> <li>• <b>Të shpjegojë</b> menaxhimin e siteve të trashëgimisë natyrore</li> <li>• <b>Të përshkruajë</b> karakteristikat dhe vlerat kryesore të siteve evropiane të Trashëgimisë Botërore: shtrirjen sipas rajoneve dhe shteteve;.</li> <li>• <b>Të përshkruajë</b> tiparet e veçanta të monitorimit dhe studimit të vazhdueshëm të vlerave; menaxhimin turistik, kulturor, didaktik të qendrave të analizuara.</li> <li>• <b>Të përcaktojë rolin e shkollës dhe të shoqërisë civile (OJF-ve)</b> në ndërgjegjësimin e opinionit për vlerat e qendrave të trashëgimisë natyrore botërore dhe për mbrojtjen e tyre.</li> </ul>
--	--

## **Linja 5: TRASHËGIMIA DHE TURIZMI KULTUROR**

**Përshkrimi i linjës:** Në këtë linjë nxënësit kuptojnë rëndësinë që ka trashëgimia natyrore dhe kulturore për zhvillimin turistik të një vendi ose të vendeve të ndryshme evropiane. Monumentet e natyrës dhe të kulturës janë pjesë e identitetit të një kombi ose kontinenti, si dhe faktorë të rëndësishëm të zhvillimit historik, ekonomik dhe social të tij. Nxënësit aftësohen për të vlerësuar turizmin si mjet të komunikimit ndërkulturor dhe për t'u bërë protagonistë të zhvillimit të tij në nivel vendor dhe evropian. Monumentet e natyrës dhe të kulturës, prodhimet artizanale, gatimi, etj mund të jenë për nxënësit objekt i ndërtimit të projekteve turistike.

**Orët e sugjeruara:10**

Linja	Objektivat
<b>Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor</b>	<p>Në përfundim të studimit të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të analizojë se ç'përfaqëson turizmi kulturor evropian</b> në kontekstin botëror.</li> <li>• <b>Të identifikojë turizmin kulturor në Evropë duke shpjeguar dhe përshkruar tipare te përgjithshme dhe veçoritë</b></li> <li>• Të përshkruajë Evropën turistike përmes agjencive të udhëtimit, faqeve të internetit, guidave etj.</li> <li>• Të përshkruajë vendet më të spikatura të turizmit kulturor në Evropë</li> <li>• Të përshkruajë lindjen dhe zhvillimin e turizmit kulturor evropian.</li> <li>• Të vlerësojë traditën evropiane në këtë fushë.</li> <li>• Të përshkruajë turizmin si mjet të komunikimit ndërkulturor.</li> <li>• Të klasifikojë veçoritë dhe vlerat e marrëdhëniet mes trashëgimisë dhe turizmit kulturor.</li> <li>• Të identifikojë problematikat në zhvillimin e këtij lloj turizmi dhe në ruajtjen e marrëdhënieve mes trashëgimisë dhe turizmit kulturor në Evropë.</li> <li>• Të vlerësojë rëndësinë e tij dhe monumentet më të vizituara</li> <li>• Të zgjedhë sitet më të vizituara.</li> <li>• <b>Të përshkruajë veçoritë gastronomike të vendeve evropiane.</b></li> <li>• Të diskutojë për traditat e gatimit evropian</li> <li>• <b>Të listojë disa lloje gatimesh dhe pijesh me traditë evropiane</b></li> <li>• <b>Të organizojë një panair ushqimesh dhe pijesh evropiane</b></li> <li>• <b>Të përshkruajë disa prej artizanateve të ushtruara në Evropë.</b></li> <li>• <b>Të listojë disa lloje punimesh artizanale</b></li> <li>• <b>Të organizojë një ekspozitë me punime evropiane ose ballkanike</b></li> <li>• Të organizojë një panair me punime artizanale në nivel rajonal (ballkanik)</li> <li>• Të realizojë në grup një guidë turistike të një rajoni ose vendi të Evropës</li> </ul>

## Linja 6: LEGJISLACIONI PËR TRASHEGIMINË NATYRORE DHE KULTURORE

**Përshkrimi i linjës:** Në këtë linjë nxënësit kuptojnë se ruajtja e vlerave natyrore dhe kulturore evropiane bëhet nëpërmjet një legjislacioni të fuqishëm për zbatimin e të cilit është përfshirë dhe vendi ynë. Marrëveshjet dhe protokollet ndërkombëtare, ligjet e vendit dhe rregullat lokale janë pjesë e linjës së legjislacionit, ku një vend të rëndësishëm zë edhe njohja me organizatën botërore për edukimin, kulturën dhe shkencën UNESCO.

**Orët e sugjeruara: 3**

Linja	Objektivat
<p><b>Legjislacioni Ndërkombëtar për Trashëgiminë dhe Kulturore Natyrore</b></p>	<p>Në përfundim të studimit të këtij programi nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të shpjegojë Konventën Ndërkombëtare për mbrojtjen dhe zhvillimin e diversitetit kulturor</b> të Parisit, 20 tetor 2005, përmbajtjen, strukturën dhe institucionet e saj; me detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga të qenit anëtar i kësaj konvente në të cilën Shqipëria u bë palë në 17 nëntor 2006;</li> <li>• <b>Të diskutojë për legjislacionin evropian</b> të trashëgimisë kulturore dhe natyrore</li> <li>• <b>Të shpjegojë</b> përmbajtjen e konventave evropiane për trashëgiminë kulturore dhe mjedisore, si:             <ol style="list-style-type: none"> <li>a. <i>Konventa evropiane e kulturës, Paris, Francë, 1954</i></li> <li>b. <i>Konventa evropiane për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike, Valleta, Spanjë, 1992</i></li> <li>c. <i>Konventa evropiane e mjedisit, Firenze, Itali, 2000</i></li> <li>d. <i>Konventa evropiane për rëndësinë e vlerave të trashëgimisë kulturore për shoqërinë, Faro, Portugali, 2005</i></li> </ol> </li> <li>• <b>Të tregojë për Konventat e UNESCO-s</b> për trashëgiminë kulturore dhe rëndësinë e tyre:             <ol style="list-style-type: none"> <li>a. <i>Konventa e UNESCO-s “Për luftën kundër trafikimit të veprave të artit dhe trashëgimisë kulturore”</i></li> <li>b. <i>Konventa e UNESCO-s “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike nënujore”.</i></li> </ol> </li> <li>• <b>Të përshkruajë statusin ligjor</b> të mbrojtjes së monumenteve të natyrës dhe kulturës: modelet më të mira në disa shtete evropiane;</li> </ul>

#### 4. KËRKESA TË LËNDËS TRASHËGIMI EVROPIANE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

<p><b>TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE</b></p>	<p><b>TIK</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Për të gjitha nënlinjat</li> </ul>	<p><b>Nxënës/i, -ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përdor word – procesor në shkrimin e materialeve dhe ndërtimin e tabelave të ndryshme.</li> <li>▪ Përdor poëer point për prezantimin e një materiali informues, projekti të bërë në grup apo individualisht (P.sh, një prezantim të vlerave të trashëgimisë kulturore të Greqisë ose Italisë)</li> <li>▪ Nxënësi kërkon në internet informacion, imazhe të ndryshme nga Evropa dhe vende të ndryshme të saj.</li> <li>▪ Njeh teknikat dhe parimet e kërkimit në Internet,</li> <li>▪ Përdor vendosjen dhe mundëson shikimin e videove.</li> <li>▪ Projekton para grupit përmes përdorimit të aparateve projektuese</li> </ul>
<p><b>TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE</b></p>	<p><b>GJEOGRAFI</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të identifikojë listën evropiane të monumenteve të kulturës dhe shpërndarjen gjeografike të tyre.</li> <li>• Të identifikojë shpërndarjen gjeografike të qendrave historike në Evropë</li> </ul>	<p><b>Nxënës/i, -ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Njeh mirë hartën politike të Evropës, shtrirjen dhe vend ndodhjen e qyteteve dhe qendrave kryesore të saj.</li> <li>▪ Njeh mirë kushtet natyrore dhe popullimin; zhvillimet sociale dhe ekonomike që kanë kushtëzuar trashëgiminë shumë të pasur natyrore dhe kulturore.</li> <li>▪ Njeh karakteristikat gjeografike që shoqërojnë monumentet e kulturës dhe të mjedisit në Evropë</li> <li>▪ Zhvillon projekte ndër kufitare ose binjakëzime me shkolla të vendeve evropiane online për shkëmbime ndërkulturore.</li> <li>▪ Zhvillon projekte lokale, rajonale dhe ndër kufitare për mjedisin dhe monumentet e kulturës</li> </ul>
<p><b>TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE</b></p>	<p><b>HISTORI</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të gjitha periudhat e zhvillimit të</li> </ul>	<p><b>Nxënës/i, -ja:</b></p>

<p>historisë njerëzore janë të lidhura me trashëgiminë natyrore dhe kulturore .</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të analizojë qendrat historike në vende të ndryshme si qendra të qytetërimit evropian</li> <li>▪</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ përshkruan ngjarjet historike, sociale, politike dhe kulturore që kanë lënë gjurmë në secilin sit të kulturës evropiane;</li> <li>▪ përshkruan kthesat e mëdha historike që kanë ndikuar fort në zhvillimin e kulturës materiale dhe shpirtërore të Evropës</li> <li>▪ një ngjarjet kryesore që lidhen me qendrat historike të Evropës</li> </ul>
<b>TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE</b>	<b>LETËRSI</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Trashëgimia shpirtërore</li> </ul>	<p><b>Nxënës/i, -ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ një krijime të folklorit të vendeve të ndryshme të Evropës</li> <li>▪ dallon vlerat e krijimeve të folklorit evropian</li> <li>▪ dallon lloje të ndryshme të folklorit evropian</li> </ul>
<b>TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE</b>	<b>BIOLOGJI</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Trashëgimia natyrore dhe kulturore</li> </ul>	<p><b>Nxënës/i, -ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përdor dhe një kuptimin e koncepteve mjedis, ekosistem, biodiversitet.</li> </ul>

## 5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar i detyrueshëm për t'u zbatuar nga përdoruesit e tij (mësues, autorë të teksteve etj). Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë etnike, kulturore, racore, gjinore dhe fetare.

Programi lëndor është vetëm një pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar në lëndën e artit pamor. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare të arteve, ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit,
- Synimeve të linjave ndërkurrikulare,

Programi i lëndës “Trashëgimia Evropiane” i drejtohet grupeve të ndryshme të përdoruesve si nxënësve, mësuesve dhe autorëve të teksteve shkollore duke synuar orientimin e tyre me objektivat e përgjithshme dhe të detyruara të përmbajtjes, si dhe ato me zgjedhje. Pjesa e theksuar i takon objektiveve të njohjes dhe aftësimit për të gjithë nxënësit, ndërsa pjesa tjetër i takon zgjedhjes që bëjnë ata për shkallën e thellimit në përmbajtje (tematika) të ndryshme.

Projektet janë një tjetër drejtim mbi të cilin mësuesit kanë lirinë e përzgjedhjes tematike. Sikurse edhe në vitin e kaluar përdoruesit e programit do të pajsen me udhëzuesin kurrikular i cili do të zbërthejë alternativa të larmishme mësimdhënie . Përdoruesit e programit duhet të marrin në konsideratë se trajtimi në tekstet mësimore të nxënësve i këtyre temave mund të realizohet i orientuar mbi objektet konkrete të trashëgimisë evropiane (materiale, shpirtërore dhe natyrore) ose mbi pasurinë kulturore dhe natyrore më të vyer të çdo vendi evropian. Një rekomandim tjetër mund të jetë edhe trajtimi i pasurisë kulturore dhe natyrore evropiane sipas periudhave historike.

## 6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat programin lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësuesi zhvillon vetë e ndihmon nxënësit dhe bashkënxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produkteve të tjera, si: prodhon një maket, realizon një projekt kurrikular, një punë praktike, etj.

Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënësi në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore, si dhe të vendosë nota në regjistrë për secilën orë mësimi. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm dhe si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e mëparshme dhe mirë kryerjes së detyrave jashtë klase.

Mësuesi duhet të vlerësojë me notë herë pas here duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara individualisht ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhura të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pak minutash për një objektivi të veçantë të të nxënësit, tek ato një orësh; teste me alternative ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Ai i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, ndërsa mësuesi rekomandon.